



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË  
EITI ALBANIA**

**SEKRETARIATI I NISMËS PËR TRANSPARENÇË NË INDUSTRIËNXJERRËSE**

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI  
(SHËRBIME KONSULENCE– PËRZGJEDHJA E FIRMAVE)**

**Republika e Shqipërisë  
Ministria e Energjisë dhe Industrisë  
Sekretariati i Nismës për Transparençë në Industrinë Nxjerrëse  
Granti Nr.: TF 014999**

**Titulli i paketës:** Studim fizibiliteti për Sistemet e Integruar të të Dhënave EITI në Shqipëri

**Nr. i Referencës:** ALBEITI/CQ/004

Kjo Kërkesë për Shprehje Interesi publikohet pas Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit për këtë projekt, i publikuar në Development Business online No. wb1346-03/14, të datës 7 Mars 2014.

Republika e Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore për llogari të Nismës për Transparençë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Shqiptar) dhe synon të përdorë një pjesë të financimit nga Granti për shërbimet e konsulencës për përzgjedhjen e një Firme për një studim fizibiliteti për Sistemet e Integruar të të Dhënave EITI në Shqipëri.

Shërbimet e konsulencës (“Shërbimet”) përfshijnë përzgjedhjen e një firme kompetente dhe të besueshme për të ofruar shërbimet: Studim fizibiliteti për të prodhuar një raport teknik i cili do të japë informacion mbi statusin aktual të sistemeve të Institucioneve Shtetërore për sa i përket mundësisë së gjenerimit të të dhënave për EITI dhe të propozojë një “Zgjidhje” IDMS për prodhimin e Integruar të të dhënave EITI.

Periodha e zbatimit të kontratës do të jetë afërsisht 40 ditë kalendarike nga nënshkrimi i Kontratës.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë fton firma konsulentë të përshtatshme (“Konsulentë”) të shprehin interesin e tyre në ofrimin e Shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të japin informacion që paraqet kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencën e përshtatshme për të kryer Shërbimet. Kriteret e përfshirjes në listën e shkurtër janë: kualifikimet e përgjithshme të Konsulentit, përshkrime të kontratave të ngjashme, disponueshmëria e kualifikimeve të duhura të stafit me njohuri të thelluara teknike me Sistemet IT dhe IDMS. Është avantazh njohja dhe eksperiencia paraardhëse me sistemet e Agjencive Shtetërore.

Konsulentëve të interesuar iu kërkohet t'i kushtojnë vëmendje paragrafit 1.9 të Udhëzimeve të Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve sipas Huave të IBRD dhe Kredive dhe Granteve të IDA nga Huamarrësit e Bankës Botërore, të datës Janar 2011* ("Udhëzimet për Konsulentët"), që përcakton politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e bashkimit të operatorëve ose të nënkonsulencës për të rritur kualifikimet e tyre.

Një Konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (CQ) të përcaktuar në Udhëzimet e Konsulentëve.

Më shumë informacion mund të merret në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08.00 deri 16.30 nga e hëna deri të enjten dhe 08.30 deri 14.00 të premten.

Shprehjet e interesit mund të dorëzohen zyrtarisht në adresën e mëposhtme (personalisht, ose me postë, ose me faks, ose me e-mail) deri më 12. 01. 2015.

*Ministria e Energjisë dhe Industrisë*

*Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Shqiptar)*

*Në vëmendje të: Znj. Dorina Çinari, Drejtuese e Sekretariatit EITI Shqiptar*

*Godina 3, mbrapa Ministrisë së Punëve të Jashtme, Kati V,*

*Zyra Nr. 406, Tiranë*

*E-mail: Dorina.Cinari@albeiti.gov.al*